

Shqip : <https://sexandfacts.ch/sq/>

Die weiblichen Genitalorgane / Les organes génitaux féminins

Organet gjentiale të femrës


Information: Diese Seite wird in Kürze überarbeitet.

Information: This page will be revised shortly.

Organi gjental i jashtëm femëror i cili përbëhet nga dy buzë të mëdha e dy të vogla, ku në brendësi të buzëve të vogla gjendet hyrja e vaginës dhe e uretrës (kanalit urinar) e cila shërben për nxjerrjen e urinës jashtë nga mëshikëza e urinës. Mbi qarjen e vaginës gjendet **klitorisi** i cili luan rol të rëndësishëm në kënaqësinë seksuale të femrës.

Nëse gruaja ose vajza është bërë synet (prerja e gjentialeve), vulva mund të ketë një pamje tjetër.

Informacione të mëtejshme www.excision.ch.



1. Tubat
2. Ovaret
3. Uterusi (Mitra)
4. Fshikëza e urinës
5. Kocka pubike
6. Uretra
7. Trupi kavernozi i klitorisit
8. Klitorisi
9. Buza e vaginës
10. Vagina
11. Cerviksi
12. Ovaria

10. Vagina
11. Qafa e mitrës
12. Zorra

Vagina

Është një kanal me gjatësi 7-10cm. Ai e pret penisin e mashkullit gjatë marrëdhënies seksuale. Vagina mund të zgjerohet dhe të ngushtohet për ta mundësuar kalimin e foshnjës gjatë lindjes. Nga ky kanal rrjedh gjaku i menstruacioneve. Dëshira seksuale provokon lëngun vaginal i cili ndihmon hyrjen e penisit në vaginë.

Hymen (cipa e vajzërisë)

Hymeni është një cipë e hollë e cila ndodhet në hyrje të vaginës forma e së cilës ndryshon prej femrës në femër. Qarja e hymenit apo pëlçitja e tij nga marrëdhënia e parë seksuale përcjellët me gjakderdhje, por jo tek të gjitha femrat.

Uterusi (mitra, ani)

Është hapësirë ku zhvillohet shtatzënia. Forma e mitrës mund të krahasohet me atë të dardhës, pjesa e ngushtë e së cilës është e kthyer në anën e poshtme. Brenda mitrës, një tajim i quajtur endometër zhvillohet gjatë çdo cikli menstrual. Në fund të çdo cikli, endometri shqitet dhe vijnë menstruacionet. Nëse fillon shtatzënia, endometri e formon një fole për embrionin.

Në fund të vaginës mund të preket me gishta një e ngritur disi e fortë e kjo është qafa e mitrës, me një vrimë që lejon kalimin e spermatozoideve dhe gjakut menstrual. Gjatë lindjes, qafa e mitrës dhe vagina hapen për t'ia përgatitur rrugën foshnjës që të dalë.

Ovaret apo vezoret

Këto janë organe ë kanë madhësinë e bajames. Kanë dy role:

- Prodhimin e hormoneve seksuale të femrës të cilat e rregullojnë ciklin menstrual, të quajtura estrogjene dhe progjesterone.
- Mundësimin e pjekjes së vezës një herë në muaj (ovulacionin).

Tubat uterine (vëzëpërçuesit)

Këto kanë formën e gypit me gjatësi 10-15 cm. Shërbejnë për përçarjen e vezës, që del nga vezoret, gjerë te mitra. Fekondimi i vezës me spermatozoid bëhet në vëzëpërçues prej nga pastaj veza e fekonduar zbret në mitër ku zhvillohet embrioni. Mund të ndodhë që veza e fekonduar të mbetet në vëzëpërçues dhe aty të zhvillohet embrioni - gjë që paraqet rrezik për shëndetin e gruas.

Cikli i femrës (menstruacioni)

Është periudha kohore nga dita e parë e menstruacioneve e deri në ditën e parë të menstruacioneve të ardhshme. Kjo periudhë kohore zgjatë prej 21 deri 35 ditë. Cikli fillon zakonisht në moshën 11-15 vjeçare dhe mbaron rreth moshës 45-55 vjeçare.

Gjatë çdo cikli, mitra përgatitet për një shtatzëni eventuale duke e zhvilluar endometrin. Dalja e vezës ndodhë 15 ditë para se të lajmërohet gjakderdhja e ardhshme. Nëse gruaja në këtë periudhë kohore ka

marrëdhënie seksuale atëherë ajo mund të mbetet shtatzëne.

Dalja e vezës asnjëherë nuk ndodh në të njëjtën kohë, prandaj metoda [Ogjino](#) (apo e llogaritjes) nuk është metodë efikase për t'u mbrojtur nga një shtatzëni e padëshiruar.

Gjatë periudhës...

... së menstruacioneve femra guxon të lahet, të bëjë dush dhe t`i pastrojë flokët. Ajo mund të ushtrojë edhe sport ose të notojë pasi ta ketë vendosur tamponin.

2017, SANTÉ SEXUELLE SUISSE, Fondation suisse pour la santé sexuelle et reproductive; ALECSS Association suisse latine des spécialistes en santé sexuelle, Éducation - Formation - Conseil; faseg, Fachverband sexuelle Gesundheit in Beratung und Bildung

Gjuha shqipe : <https://sexandfacts.ch/sq/organet-gjenitale/organet-gjenitale-te-femres>